



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETSËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

27 - 29 Shkurt 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Analizat për efektet e terapisë, tash e tutje me participim

Shkup, 25 shkurt - Me participim më së shumti deri në 1.000 denarë, pacientët, në radhë të parë ata me sëmundje malinje do të mund të bëjnë mbi 30 lloje të analizave për të ndjekur efektin e terapisë së personalizuar, e të cilat punohen në laboratorin për analiza biomolekulare farmaceutike në Fakultetin e Farmacisë.

Kjo është paraparë në marrëveshjen të cilën sot e lidhën Fakulteti i Farmacisë dhe Fondi i Sigurimit Shëndetësor, i cili do të paguajë pjesën më të madhe të shumës së nevojshme për këtë lloj të testimit.

Këto analiza pacientët deri tani i kanë paguar privatisht dhe disa prej tyre kanë dhënë deri në 11.000 denarë. Por në të ardhmen, ato do t'i bëjnë me udhëzime nga klinika, njofton Zhurnal.

"Marrëveshja do të mundësojë shkallë më të lartë të shfrytëzimit të mjekësisë të personalizuar dhe ofrimin e shërbimeve për rreth 600 pacientë në vit, të cilët më parë kanë paguar me mjete të veta. Tani ato do të mbulohen nga Fondi", tha ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov.

Drejtori i Fondit, Sasho Stefanovski, theksoi se Fakulteti i Farmacisë do të faturojë shërbime të cilat i kryen në bazë të kësaj marrëveshjeje, ndërsa Fondi do të rimbursojë shpenzimet.

"Më e rëndësishme është që të shkoni një hap përpara, ngrihet niveli i përcaktimit të asaj se cilat ilaçe janë efektive për trajtimin e pacientëve," tha Stefanovski.

ALARM në Maqedoni, për vetëm 3 muaj vdesin 53 foshnje

Shkup, 26 shkurt – Agjencia e lajmeve Zhurnal gjatë një hulumtimi që bëri ditën e sotshme në shifra tepër alarmante që gjatë tre muajve të fundit të vitit 2015/2016, 53 foshnje të moshës deri më një vjeç vdesin në Maqedoni.

Këto shifra alarmante për herë të parë i ka publikuar Enti shtetërorë për statistika, ku thuhet se vetëm gjatë tre muajve të fundit 2015/2016 në Maqedoni kanë ndërruar jetë 53 foshnje të sapolindura. Kjo shifër po dëshmon qartë edhe alarmin të cilën para një viti e ngriti Agjencia e lajmeve Zhurnal, se në rajonin e Tetovës vetëm gjatë një viti ka pasur afro 100 foshnje të vdekura.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Enti shtetërorë për statistika konstaton se gjatë muajit tetorë deri në muajin dhjetor të vitit 2015, numri i foshnjeve të vdekura ka arritur jashtë normales duke ndërruar jetë 53 foshnje, njofton Zhurnal.

Ndryshe nëse bëhet një analizë e vogël ku për tre muaj kanë vdekur 53 foshnje, atëherë gjatë një viti në Maqedoni mesatarisht ndërrojnë jetë afro 200 foshnje.

Agjencia e lajmeve Zhurnal bënë apel deri tek gjithë institucionet shëndetësore që të ndërmerren masa për parandalimin e numrit të madh të vdekjeve të foshnjeve të sapolindura.

Me këtë rast Zhurnal rekomandon dhe apelon që Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë që të përpiloj strategji dhe plan dhe të marrin masa për ta parandaluar këtë fenomen.

Zhurnal para një viti senzibilizoi opinionin në lidhje me foshnjat e sapolindura në rajonin e Tetovës, kjo temë madje u bë temë debati nga një numër i madh i mjekëve dhe enkas për këtë temë u trajtua edhe një emision dokumentarë nga Kosova, nga Koha Televizion me titull "Ajër për Tetovën".

Më poshtë Agjencia e lajmeve Zhurnal ua sjellë kronikën gazetareske të cilën e realizoi "Koha Televizion", nga Kosova, enkas për lajmin të cilën pati trajtuar një vit më parë, Zhurnal.



Klinika e fëmijëve, aplikohet lloji i ri i alergotestit

Metodë e re për vërtetimin e alergjisë tek fëmijët, po aplikohet në klinikën e fëmijëve në Shkup...



Nëpërmjet gjakut me laboratorin e ri mund të vërtetohet lloji i alergjisë për një kohë të shkurtër, ndërkaq rezultatet janë me një skatësi të lartë.

Vetëm në gjashtë muajt e fundit, 2 mijë e 500 fëmijë kanë bërë këtë llojë të alergotestit. Është vërtetuar se numri më i madh i fëmijëve janë alergjik nga ajri i ndotur, ndërkaq në vend të dytë si arsye për shfaqjen e alergjisë renditet ushqimi.

Drejtoresha e klinikës Aspazija Sofijanova thotë se tani edhe tek foshnjat e posalindura mund të identifkohen predispozitat për ndonjë alergji.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



“Përparësia në mjekësi është se sa më herët që zbulohet predispozita ndaj sëmundjes së caktuar që ajo edhe të parandalohet. Ne do të mund shumë herët se çfarë lloj alergjie mund të paraqitet tek fëmija që ta parandalojmë atë”, shprehet drejtoresha e klinikës për sëmundje të fëmijëve Aspazija Sofijanova.

Laboratori i ri mundëson 400 teste në orë për 400 lloje të alergjive, ndërkaq mund të shfrytëzohete dhe nga klinikat e tjera.

“Nevoja për një aparat të këstillë është e madhe. Pres që ky aparat të shfrytëzohet nga i gjithë sistemi shëndetësor. Me të mund të bëhen gjitha analizat të cilat janë më se të nevojshme dhe ndihmojnë mjekëve gjatë dhënies së terapisë gjegjësisht dijagnozës”, shprehet ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov.

Sipas disa statistikave europiane deri më 150 milion njerëz në europë vuajnë nga alergjitë. Një në 20 fëmijë kanë një ose më shumë alergji të shkaktuar nga ndonjë lloj ushqimi.

Në Kërçovë rritet numri i vullnetarëve për dhurimin e gjakut

Kryqi i Kuq në Kërçovë, njofton se numri i vullnetarëve për dhurimin e gjakut në Kërçovë është rritur për 20 përqind...



Në aksionin e parë të këtij viti janë grumbulluar 80 njësi të gjakut.

Në bashkëpunim me Institutin e Transfuziologjisë, vitin e kaluar janë grumbulluar 922 njësi gjaku dhe me aksionet e realizuara është përmbushur planifikimi vjetor, thotë sekretari i Kryqit të Kuq në Kërçovë, Besnik Selimi i cili shton se krahasuar me vitin 2014, vitin e kaluar është shënuar rritje grumbullimit të sasive të gjakut për 20 përqind.

Viti 2016, thotë ai, ka filluar me aksionin e zhvilluar në stacionin policor ndërkohë që në Institutin e Transfuziologjisë vullnetarët vazhdojnë të dhurojnë gjakun e tyre dhe nga fillimi i këtij viti e deri më tani, janë grumbulluar 80 njësi të gjakut.

Duke shpalosur sukseset e arritura gjatë kësaj periudhe, Selimi nënvizon rritjen permanente të dhuruesve të gjakut dhe njëherit edhe ngritjen e vetëdijes për këtë akt shumë sublim me të cilin shpëtohen jetë njerëzish.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Shënim i Ditës ndërkombëtare të sëmundjeve të rralla



Dita ndërkombëtare e sëmundjeve të rralla do të shënohet sot në organizim të Aleancës nacionale për sëmundje të rralla të Republikës së Maqedonisë...

Motoja vjetore e Ditës ndërkombëtare është "Bashkangjiteti, që të dëgjohet zëri i sëmundjeve të rralla.

Qëllimi i shënimit të Ditës ndërkombëtare të sëmundjeve të rralla, ngjarje ndërkombëtare në koordinim me Organizatën evropiane për sëmundje të rralla Eurordis, është arritja e ndërgjegjies publike për sëmundjet e rralla dhe ndikimi, që e

kanë ato në cilësinë e jetesës së pacientëve dhe të familjeve të tyre./Mia

PORTALB
dritare realiteti

Tetovë, thuajse çdo fëmijë me probleme me rritjen dhe zhvillimin



Kontrollet e fundit sistematike të nxënësve në klasat e ulëta në Tetovë, japin të dhëna alarmante për gjendjen e keqe të të rinjëve. Diku 80 përqind e nxënësve të rinj, të moshës nga 6 deri në 10 vjet kanë devijime në rritjen dhe zhvillimin normal, të tilla si qëndrim jo i drejtë i trupit, probleme më këmbët, trashje dhe probleme shikimi, njofton REL, transmeton Portalb.

"Mund të themi se fëmijët tetovarë e ndjekin trendin e përgjithshëm në Maqedoni, por edhe ati në botë. Gjithnjë e më shumë ka fëmijë të deformuar. Me herët nga të gjithë fëmijët që i kemi kontrolluar diku 10 përqind ishin me probleme shtrembërimi, 20 përqind e tyre ishin me devijime në qëndrimin jo të drejtë të trupit. Sot numri i fëmijëve më qëndrim jo të drejtë të trupit është 80 përqind", tha mjeku Aleksandar Kosteski, specialist për mjekësi shkollore në shtëpinë shëndetësore të Tetovës.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Sipas tij, Shoqata e mjekëve për mjekim shkollorë, para 10 viteve parashikoi problemin dhe kërkoi futjen e më shumë orëve të edukimit fizik për nxënësit ashtu si vendet europiane të cilat kanë orë të tilla çdo ditë, transmeton Portalb.

“Arsye për këtë janë mungesa e aktiviteteve fizike, ose ndryshe kurrfarë aktiviteti fizik”, tha Kosteski.

Përderisa te nxënësi vërehet qëndrim jo i drejtë i trupit, duhet sa më shpejtë, e më së voni në vitin e dytë të shkollës së mesme të fillohet me ushtrime për të parandaluar deformimet. Por në vend që të shërohet më mirë është të parandalohet. Prindërit e kanë rolin kryesorë, thotë mjeku.

“Të mos u lejojnë fëmijëve shumë kohë të qëndrojnë në tablet, lap-top e kompjuter. Vetë ata duhet të kenë përkujdesje më të madhe për fëmijët. Mjafton të dalin me ta të paktën për një shëtitje. Nëse kanë mundësi të njëjtit të merren me ndonjë sport. Si sport i mirë mund të jetë volejboli. Për fat të keq nuk mund ta them këtë për notin, sepse e dimë që në Tetovë nuk ka pishinë të mbyllur. Përndryshe, noti është sporti më i mirë që i aktivizon të gjithë muskujt dhe ndihmon në zhvillimin e duhur të fëmijës”, shtoi mjeku.

Rekomandohet që fëmijët të mos qëndrojnë më shumë se 45 minuta në kompjuter ose tablet dhe të paktën 20 minuta të merren me aktivitete fizike.



Rritet natalitetit, zvogëlohet mortaliteti në Maqedoni



Numri i fëmijëve të lindur të gjallë në Maqedoni në tremujorin e katërt të vitit 2015 është 5.758, që është rritje për 0,6 për qind në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak, ndërsa rritja natyrore është 665 persona.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, numri i personave të vdekur në tremujorin e katërt të vitit 2015 është zvogëluar për 1,3 për qind në krahasim me tremujorin e njejtë të vitit 2014 dhe është 5.093 prej të cilëve 53 janë foshnje të vdekura.

Në tremujorin e katërt të vitit të kaluar janë lidhur 3.494 martesë ose për 6,7 për qind më shumë në krahasim me periudhën e njejtë të vitit 2014. Numri i martesave të realizuara në këtë tremujor, madje, shënon ulje prej 23,6 për qind dhe është 507.